



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot.No.	226V
Nr. i faqeve Br.stranica No. pages	38
Data: Datum:	23.05.2020
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr. 362/V/2020

Datë.03.05.2020

Në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë për bazë nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës; nenin 12 paragrafi 1.11 dhe nenin 89 të Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi; nenin 8, paragrafi 1.4 dhe Shtojcën 10 paragrafi 1 të Rregullores nr.05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (19.02.2020); nenet 3, 4, 41, 44, 47 dhe 53 të Ligjit nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse; nenet 44, 46 dhe 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; dhe nenin 27 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative; në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/11 datë 15.03.2020, si dhe në përputhje të plotë me Aktgjykimiet e Gjykatës Kushtetuese nr. KO54/20 dhe KO61/20, Ministri në detyrë i Ministrisë së Shëndetësisë, nxjerr:

V E N D I M

**për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19
në territorin e Komunës së Obiliqit**

I. Prej datës 04 Maj 2020 në orën 00:00, ndalohet qarkullimi i personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në Komunën e Obiliqit përveç rasteve në vijim:

- (a) **Për personat fizikë mbi moshën 16 vjeçare** lejohet qarkullimi për furnizim me mallra të domosdoshme (ushqim dhe barna për njerëz dhe kafshë/shpezë, si dhe produkte higjienike) dhe për të kryer detyrat dhe nevojat financiare (pagesat, punët bankare), **vetëm dy herë gjatë ditës nga 90 minuta**, sipas orarit të përcaktuar javor në bazë të shifrës së parafundit të numrit të tyre personal. Orari është i bashkëngjitur këtij vendimi (shih Aneksin 1) dhe do t'i nënshtrohet rotacionit dy herë në javë. Për shtetasit e huaj që nuk posedojnë numër personal të Republikës së Kosovës, orari i lejuar i daljes përcaktohet bazuar në shifrën e parafundit të numrit të pasaportës ose të letërnjoftimit të shtetit të huaj.
- (b) Gjatë qarkullimit të personave fizikë, **nuk lejohet shoqërimi nga askush**, përveç në tri raste:
 - (1) **personat me aftësi të kufizuara**, të cilët mund të shoqërohen vetëm nga një anëtar tjetër i së njëjtës bashkësi familjare, apo nga një asistent mjekësor/shëndetësor.

- (2) **personat nën moshën 16 vjeçare**, me kusht që të jenë të shoqëruar nga një anëtar i së njëjtës bashkësie familjare.
- (3) **kafshët shtëpiake**, me kusht që të mbahen të lidhura në çdo kohë gjatë orarit të lejuar të daljes.
- (c) Gjatë orareve të përcaktuara të lëvizjes së lirë në bazë të numrit personal, personat fizikë mund të dalin jashtë banesave/shtëpive të tyre për të kryer ushtrime fizike. Përveç përjashtimeve në pikën (b), **nuk lejohet shoqërim nga askush gjatë kryerjes së ushtrimeve fizike.**
- (d) Për shkak të rrezikshmërisë së lartë të COVID-19 ndaj të moshuarve, **rekomandohet** që personat mbi moshën 65 vjeçare të mos dalin nga shtëpia/banesa, përveç për raste urgjente dhe kur është e domosdoshme.
- (e) Me dokument konfirmimi nga ATK EDI dhe **vetëm për të kryer nevojat e operatorëve ekonomikë apo institucioneve përkatëse**, mundësohet:
 - (1) qarkullimi i lirë për operatorët ekonomikë dhe institucionet e parapara në listën e bashkëngjitur si Aneksi 2 dhe 3 të këtij vendimi.
 - (2) transporti i lirë i mallrave dhe shërbimeve për të siguruar funksionimin e zinxhirit të furnizimit — si proces që përfshin veprimet nga lënda e parë në prodhim, përpunim e shërbim gjer te transporti i produkteve, shpërndarja dhe shitja te konsumatori i fundit — për veprimtaritë e lejuara sipas Aneksit 2 të këtij vendimi.
- (f) Lejohet qarkullimi i lirë për institucionet në listën e bashkëngjitur si Aneksi 3 i këtij vendimi, **vetëm për të kryer detyrat zyrtare.**
- (g) Në raste urgjente të shëndetësisë, lejohet dalja nga shtëpia/banesa për të kërkuar trajtim mjekësor në një institucion shëndetësor.
- (h) Lejohet qarkullimi për personat fizikë në raste ku dalja nga shtëpia/banesa është e domosdoshme për t'u kujdesur për një ose më shumë të sëmurë, ose për një ose më shumë persona me aftësi të kufizuara, **vetëm nëse të sëmurët apo personat me aftësi të kufizuara nuk kanë mundësi të kujdesen për vetveten.**
- (i) Ndalimi i qarkullimit të personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre nuk zbatohet në raste të viktimave të dhunës familjare. Viktimave të dhunës familjare u lejohet të dalin nga shtëpitë/banesat e tyre për të kërkuar strehim në një lokacion alternativ.
- (j) Në raste të vdekjes, lejohet dalja nga shtëpia/banesa për të marrë pjesë në varrim, **por vetëm për familjarët e ngushtë të të ndjerit.**
- (k) Ndalohet rreptësisht dalja nga shtëpitë/banesat për çfarëdo arsye tjetër përveç për arsyet e lartcekura, duke përfshirë në këtë ndalim takime shoqërore, vizita familjare, etj.
- (l) Lejohet dalja nga shtëpia/banesa me kafshët shtëpiake jashtë orarit të lejuar të daljes, për nevojat fiziologjike të këtyre kafshëve, por jo më larg se 500 metra nga banesa/shtëpia. Nuk lejohet shfrytëzimi i këtyre rasteve për të kryer ndonjë punë tjetër ose për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të përcaktuar.

II. Prej datës 04 Maj në orën 00:00, ndalohet qarkullimi i automjeteve në Komunën e Obiliqit, përveçse:

- (a) Me dokument konfirmimi nga ATK sistemi EDI dhe **vetëm për të kryer nevojat e operatorëve ekonomikë**, mundësohet:
 - (1) qarkullimi i automjeteve për operatorët ekonomikë dhe institucionet e parapara në listën e bashkëngjitur si Aneksi 2 dhe 3 i këtij vendimi.

- (2) lëvizja e punëtorëve, vetëm për të shkuar në punë dhe për t'u kthyer nga puna, sipas orarit të operatorit përkatës ekonomik. Punëtori ka të drejtë të shfrytëzojë edhe veturën personale.
- (3) transporti i lirë i mallrave dhe shërbimeve për të siguruar funksionimin e zinxhirit të furnizimit — si proces që përfshin veprimet nga lënda e parë në prodhim, përpunim e shërbim gjer te transporti i produkteve, shpërndarja dhe shitja te konsumatori i fundit — për veprimtaritë e lejuara sipas Aneksit 2 të këtij vendimi.
- (b) Orari i qarkullimit për bujqit dhe punonjësit në fermë është 06:00 – 20:00. Për bujqit, në kohën e qarkullimit nevojiten: (i) Certifikata e Regjistrimit të Fermerit, (ii) Aneksi 1 i Certifikatës – Shënimet e Fermerit të Regjistruar dhe (iii) Letërnjoftimi.
- (c) Punonjësit e fermave do të pajisen me dokument konfirmimi nga MBPZhR vetëm për të kryer nevojat e punës në fermën përkatëse.
- (d) Me leje të veçantë të qarkullimit dhe **vetëm për të kryer nevojat e institucioneve shtetërore**, lejohet qarkullimi i automjeteve për stafin esencial të këtyre institucioneve.
- (e) Lejohet qarkullimi me automjete për personat të cilët marketin/barnatoren/bankën/pikën e pagesës më të afërt e kanë më shumë se 2km larg. Në këto raste, nuk lejohet përdorimi i automjetit për të udhëtuar te ndonjë market/barnatore/bankë/pikë e pagesës përveç atij më të afërt.
- (f) **Vetëm për të kryer detyrat zyrtare**, lejohet qarkullimi i automjeteve për institucionet në listën e bashkëngjitur si Aneksi 3 i këtij vendimi.
- (g) Lejet për qarkullim në raste të specifikuara më sipër nga Aneksi 3 lëshohen nga MPBAP.
- (h) Lejohet qarkullimi i automjeteve për personat me aftësi fizike të kufizuara që e bëjnë të domosdoshëm përdorimin e automjeteve.
- (i) Lejohet përdorimi i automjetit për të udhëtuar te një institucion shëndetësor për të kërkuar trajtim.
- (j) Në raste të vdekjes, lejohet përdorimi i automjetit për të marrë pjesë në varrim, **por vetëm për familjarët e ngushtë të të ndjerit**.
- (k) **Përveç për arsyen e përcaktuar në pikën I, nuk lejohet më shumë se dy persona në një automjet.**
- (l) Përjashtimisht, ekipet e mediave të cilat punojnë në terren lejohen të kenë deri në 3 persona në automjet me kusht që të 3 pasagjerët të kenë maskë speciale FFP2 plus dorëza të vendosura.

III. Gjatë qarkullimit të lejueshëm sipas përjashtimeve të parashikuara në pikat I dhe II më lart, personat fizikë obligohen:

- (a) të mbajnë të mbuluara vetëm gojën dhe hundën, përmes maskës, shallit, apo ndonjë mbulese tjetër;
- (b) në çdo kohë, të ruajnë distancë prej dy metrash nga persona të tjerë.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri më 18 maj 2020. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet çdo dispozitë e mëparshme që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij Vendimi.

V. Ky vendim do të rishqyrtohet jo më vonë se 16 maj 2020, në konsultim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, ekspertët dhe ministrinë e tjera të linjës, për të vlerësuar efikasitetin dhe domosdoshmërinë e masave të përcaktuara, si dhe për të vendosur për vazhdimin ose jo të masave përkatëse.

VI. Përveç pikës IV dhe V, Ministri i Shëndetësisë do ta ri-analizojë situatën epidemiologjike çdo ditë dhe në lidhje me secilën pikë të lartcekur dhe, pas konsultave paraprake, mund të ndryshojë, plotësojë apo shfuqizojë masat e përcaktuara.

A r s y e t i m

Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës, si dhe në përputhje të plotë me Aktgjykimiet e Gjykatës Kushtetuese nr. KO54/20 dhe KO61/20, Ministria e Shëndetësisë bazuar në kompetencat e saja te përcaktuara në Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Arben Vitia

Ministër në detyrë i Shëndetësisë



Vendimi iu dërgohet:

- *Kryeministrit të Republikës së Kosovës;*
- *Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm MSh,*
- *Departamentit Ligjor MSh,*
- *IKSHPK-së;*
- *Kryetarit/es të Komunës Obiliqit;*
- *Policisë së Kosovës;*
- *Inspektoratit sanitar;*
- *Qendrës operative emergjente në MSh;*
- *Arkivit të MSh.*



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister**

Br. 362/V/2020
Datum.03.05.2020

Na osnovu člana 145. (tačka 2). Ustava Republike Kosova, i članova 10 i 11 Zakona br. 06 / L-113 o organizaciji i funkcionisanju državne uprave i nezavisnih agencija Republike Kosovo, na osnovu člana 12 stav 1.11 i člana 89 Zakona br.04 / L-125 o zdravstvu, člana 8. stav 1.4. i Priloga 10. stava 1. Uredbe br. 05/2020 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava (19.02.2020.), na osnovu članova 3,4,41,44,47 i 53. Zakona br. 02 / L-109 o sprečavanju i suzbijanju zaraznih bolesti; članova,44,46 i 47 Zakona br.05-L-031 o opštim administrativnim procedurama ; i članu 27 Zakona br. 03 / L-202 o upravnim sporovima u skladu sa Odlukom Vlade Republike Kosova br. 01/11 od 15.03.2020. ., kao i u skladu sa presudama Ustavnog suda br. KO54 / 20 i KO61 / 20, ministar zdravstva na dužnosti, donosi,

ODLUKU

o sprečavanju, suzbijanju i eliminaciji zarazne bolesti COVID-19 na teritoriji opštine Obilić

I. Od 04. maja 2020. u 00:00 zabranjeno je kretanje fizičkih osoba izvan njihovih domova / stanova u opštini Obilić, osim u sledećim slučajevima:

a) **Za fizičke osobe starije od 16 godina** dozvoljeno je kretanje za snabdevanje neophodne robe (hrana i lekovi za ljude i životinje / živinu kao i higijenske proizvode) i za obavljanje dužnosti i finansijskih obaveza (plaćanja, bankarske obaveze) **dva puta dnevno u trajanju od 90 minuta**, prema postavljenom nedeljnom rasporedu na osnovu prethodnog broja ličnog broja. Raspored je priložen uz ovu odluku (vidi Prilog 1) i menjaće se dva puta nedeljno. Za strane državljane koji nemaju lični broj Republike Kosovo, dozvoljeni raspored izlaza utvrđuje se na osnovu prethodnog ličnog broja pasoša ili lične karte strane države.

(b) Za vreme kretanja fizičkih osoba nije dopuštena pratnja, osim u tri slučaja:

(1) **osobe sa ograničenim sposobnostima** može pratiti osoba koja je član iste porodične zajednice, ili specijalni medicinski asistent i

(2) **osobe mlađe od 16 godina** može pratiti osoba pod uslovom da je član iste porodične zajednice u istoj kući / prebivalištu.

3) **domaće životinje**, pod uslovom da su vezane svo vreme tokom dozvoljenog izlaska.

c) Tokom dozvoljenih sati slobodnog kretanja, na osnovu ličnog broja, fizička lica mogu napustiti svoje domova radi fizičkog vežbanja. Osim izuzetaka iz tačke (b), **nije dopuštena ničija pratnja tokom izvođenja fizičkih vežbi.**

(d) Zbog visokog rizika od COVID-19 za starije osobe, **preporučuje** se osobama starijim od 65 godina da ne izlaze iz kuće / stana, osim u hitnim i neophodnim slučajevima.

(e) Uz posebnu dozvolu APK EDI-a i **samo za zadovoljenje potreba privrednih subjekata ili relevantnih institucija**, omogućava se:

(1) slobodno kretanje ekonomskih operatera i institucija koji su navedeni na listi koja je priložena kao Prilog 2 i 3 ove odluke.

(2) slobodan prevoz robe i usluga radi osiguranja funkcionisanja lanca snabdevanja - kao procesa koji obuhvata delatnosti od početne sirovine u proizvodnji, prerade do transportnih usluga proizvoda, distribuciju i prodaju do krajnjeg potrošača –za dozvoljene delatnosti prema Prilogu 2 ove odluke.

f) Dozvoljeno je slobodno kretanje za institucije koje se nalaze u Prilogu 3 ove odluke samo radi obavljanja svojih dužnosti .

(g) U hitnim zdravstvenim slučajevima, dozvoljeno je napustiti kuću / stan radi zdravstvene zaštite u zdravstvenoj ustanovi.

(h) Dozvoljeno je kretanje za fizičke osobe u slučajevima kada se staraju o jednoj ili više bolesnih osoba ili jednoj ili više osoba sa ograničenim sposobnostima, samo u slučaju kada se bolesne osobe ili osobe sa ograničenim sposobnostima ne mogu starati o sebi.

(i) Zabrana kretanja fizičkih osoba izvan njihovih domova / stanova ne primenjuje se u slučajevima žrtava nasilja u porodici. Žrtvama porodičnog nasilja dopušteno je da napuste svoje domove / stanove kako bi utočište zatražile na alternativnoj lokaciji.

j) U slučaju sahrane dopušteno je napustiti kuću / stan da bi se prisustvovalo sahrani, ali samo za blisku rodbinu pokojnika.

k) Strogo je zabranjeno napuštanje kuća / stanova iz bilo kojeg drugog razloga osim gore navedenih, uključujući društvena okupljanja, porodične posete itd.

l) Dozvoljeno je napuštanje kuće / stana sa kućnim ljubimcima izvan dozvoljenog vremena izlaska, za fiziološke potrebe ovih životinja, ali ne više od 500 metara od apartmana / kuće. Nije dozvoljeno koristiti ove slučajeve za obavljanje bilo kojeg drugog posla ili u bilo koju drugu svrhu osim one koja je navedena.

II. Od 04. maja u 00:00 zabranjeno je kretanje vozila na području opštine Obilić, osim:

- a) Uz posebnu dozvolu APK i sistema EDI samo za obavljanje potreba privrednih subjekata omogućuje se:

1) promet vozila za privredne subjekte i institucije navedene na listi priloženoj ka Prilogu 2. i 3. ove odluke.

(2) kretanje radnika, samo radi odlaska na posao i povratka sa posla, prema rasporedu odgovarajućeg ekonomskog operatera. Radnik ima pravo da se vozi i ličnim automobilom.

3) slobodan prevoz robe i usluga radi osiguranja lanca snabdevanja - kao procesa koji uključuje delatnosti od početne sirovine u proizvodnji, obrade i usluge prevoza proizvoda, distribucije i prodaje do krajnjeg potrošača - za dozvoljene delatnosti koje su navedene u Prilogu 2 ove odluke.

b) Raspored kretanja poljoprivrednika i radnika na farmi je od 06:00 - 20:00. Za poljoprivrednike su za vreme kretanja potrebni: (i) Potvrda o registraciji poljoprivrednika, (ii) Prilog 1 potvrde – Registrovani podaci o poljoprivredniku i (iii) lična karta.

c) Zaposleni na farmama će dobiti potvrdni dokument od MUPZRSU -a samo za obavljanje rada na dotičnoj farmi.

(d) Uz posebnu dozvolu i samo za obavljanje potreba državnih institucija, dozvoljava se promet vozila za "osnovno osoblje" tih institucija.

e) Dozvoljen je promet vozilima za osobe kojima je prodavnica /apoteka/ banka /mesto plaćanja udaljeno više od 2 km. U tim slučajevima nije dopušteno korišćenje vozila za putovanje na bilo koje tržište /apoteku / banku / mesto plaćanja koje nije najbliže.

f.) Dozvoljen je promet vozila samo da bi institucije obavile službene dužnosti, navedene na listi priloženoj u Prilogu 3 ove odluke.

g) Dozvole za promet za posebne slučajeve koji su navedeni u Prilogu 3 izdaje MUPJU.

(h) Dozvoljen je promet vozila osobama sa ograničenim sposobnostima kojima je upotreba vozila neophodna.

i) Dozvoljen je promet vozila do zdravstvene ustanove radi zdravstvene zaštite.

j) U smrtnom slučaju dozvoljena je upotreba vozila za prisustvovanje na sahrani, ali samo za blisku rodbinu pokojnika.

k) Osim razloga navedenog u tački l, u jednom vozilu nisu dopuštene više od dve osobe.

(l) Izuzetak čine medijske ekipe koje rade na terenu i koje mogu imati do 3 osobe u vozilu pod uslovom da imaju specijalne maske FFP2 i rukavice.

III. Za vreme dozvoljenog kretanja prema predviđenim izuzecima u gorenavedenim tačkama I i II, fizičke osobe dužne su:

(a) da pokriju usta i nos maskom, šalom ili drugim pokrivačem;

(b) u svako vreme, da se drže udaljenosti od dva metra od drugih osoba.

IV . Odluka stupa na snagu danom potpisivanja i važi do 18. maja 2020. Stupanjem na snagu ove odluke ukida se svaka prethodna odredba koja nije u skladu sa odredbama ove odluke.

V. Ova će odluka biti preispitana najkasnije **do 16.maja 2020.** u saradnji sa Nacionalnim institutom za javno zdravstvo, stručnjacima i drugim resornim ministarstvima, kako bi se procenila efikasnost i nužnost propisanih mera i odlučilo o daljem nastavljaju ili izmeni relevantnih mera.

VI. Osim tačke IV i V, ministar zdravstva će svakog dana ponovno analizirati epidemiološku situaciju i u vezi sa svakom od gore navedenih tačaka će nakon prethodnih savetovanja promeniti, dopuniti ili ukinuti propisane mere.

O b r a z l o ž e n j e

U cilju sprečavanja i suzbijanja pandemije COVID-19 u Republici Kosovo, u punom skladu sa presudama Ustavnog suda br. KO54 / 20 i KO61 / 20, Ministarstvo zdravstva na osnovu svojih nadležnosti definisanih Zakonom br. 02 / L-109 o sprečavanju i suzbijanju zaraznih bolesti, odlučilo je kao u dizpozitivu ove odluke.

Arben Vitia

Ministar zdravstva na dužnosti

Odluka se dostavlja:

- *Premijeru Kosova;*
- *Generalnom sekretaru Ministarstva zdravstva*
 - *Ministarstvu unutrašnjih poslova i javne uprave;*
- *NIJZK*
- *Predsedniku opštine Obilić*
- *Policiji Kosova;*
- *Pravnom departmanu MZ*
- *Sanitarnom inspektoratu*
- *Operativnom emergentnom centru pri Ministarstvu zdravstva;*
- *Arhivi MZ*



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

No. 362/V/2020
Date: May 03, 2020

Pursuant to Article 145, paragraph 2, of the Constitution of the Republic of Kosovo, and on the basis of Articles 10 and 11 of the Law No. 06/L-113 on the Organization and Functioning of State Administration and Independent Agencies of the Republic of Kosovo; Article 12, paragraph 1.11, and Article 89 of the Law No. 04/L-125 on Health; Article 8, paragraph 1.4 and Annex 10, paragraph 1 of Regulation No. 05/2020 on the Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries (19.02.2020); Articles 3, 4, 33, 41, 44, 47 and 53 of the Law No. 02/L-109 on the Prevention and Fighting Against Infectious Diseases, Articles 44, 46 and 47 of the Law No. 05/L-031 on the General Administrative Procedure; and Article 27 of the Law No. 03/L-202 on Administrative Disputes; implementing the Decision of the Government of the Republic of Kosovo No. 01/11 dated March 15, 2020, and in full compliance with the Judgments of the Constitutional Court No. KO54/20 and KO61/20, the caretaker Minister of Health issues the following:

DECISION

On the prevention, fighting and elimination of the contagious disease COVID-19 in the territory of the Municipality of Obiliq

- I. As of May 04, 2020, starting at 00:00h hours, movement is prohibited for natural persons outside their houses/apartments in the Municipality of Obiliq, except as follows:**
- (a) **For natural persons over the age of 16**, movement is allowed for the supply of necessary goods (food and medicine for people and animals/poultry and hygienic products) and to fulfill financial obligations and needs (payments, banking), **twice a day only for 90 minutes each**, according to the weekly schedule based on the second to last digit of their personal number. The schedule is attached to this decision (See Annex 1) and will be subject to rotation twice per week. Foreign

nationals who do not possess a Republic of Kosovo personal number, the allowed movement as per the schedule is determined based on the second to last digit of the foreign passport number or ID card.

- (b) When exercising the allowed movement schedule, natural persons are **not allowed to be accompanied** by any other person, except in three cases:
 - 1) **Persons with disabilities**, who may be accompanied only by one other member of the same family community, or by a medical/healthcare assistant
 - 2) **Persons under the age of 16**, provided they are accompanied by a member of the same family community,
 - 3) **Pets**, provided they are held on a leash at all times while exercising the allowed movement schedule.
- (c) During the 90-minute allowed movement period based on the personal number, natural persons may exit their houses/apartments to perform physical exercise. Except for the exceptions under item (b) **when conducting physical exercises accompaniment is not allowed, by any person.**
- (d) Due to the high risk of COVID-19 for the elderly, persons over the age of 65 **are recommended** not to leave their house/apartment, except in urgencies and when necessary.
- (e) With a TAK EDI confirmation and **only to conduct the needs of economic operators or relevant institutions**, the following is allowed:
 - 1) movement of economic operators and institutions as envisaged in the list attached as Annex 2 and 3 of this Decision,
 - 2) free transport of goods and services to ensure the functioning of the supply chain – as a process that includes actions from raw material to production, processing and services to the transport of products, distribution and sale to the end-consumers – for activities allowed as per the Annex 2 of this decision.
- (f) Free movement is allowed for institutions as per the attached list as Annex 3 to this Decision, **only to perform official duties.**
- (g) In health emergencies, movement outside the house/apartment is allowed to seek medical treatment in a health institution.
- (h) Movement is allowed for natural persons in cases where such movement outside the house/apartment is necessary to care for one or more persons in sickness, or for one or more persons with disabilities, **only of the sick persons or those with disabilities cannot care for themselves.**
- (i) The prohibition of movement for natural persons outside their houses/apartments does not apply in cases of domestic violence victims. Victims of domestic violence are allowed to leave their homes/apartments to seek refuge in an alternative location.

- (j) In cases of death, participation the burial is allowed, **only for the close family members of the deceased person.**
- (k) Movement outside the house/apartment for any reason other than above, including social gatherings, family visits, etc., is strictly prohibited.
- (l) It is permissible to leave the house/apartment with pets outside of the allowed time, for physiological needs of animals, but not more than 500 meters from the apartment/house. It is not permitted to use these instances to perform any other work or for any purpose other than the specified one.

II. As of May 04, starting at 00:00 hours, movement of vehicles is prohibited in the Municipality of Obiliq, except as follows:

- (a) With a TAK EDI confirmation and **only to conduct the needs of economic operators or relevant institutions**, the following is allowed:
 - (1) movement of vehicles of economic operators and institutions as envisaged in the list attached as Annex 2 and 3 of this Decision,
 - (2) movement of employees, only to commute to work and return from work, as per the working schedule of the economic operator. Employees are also allowed to use personal vehicles.
 - (3) free transport of goods and services to ensure the functioning of the supply chain – as a process that includes actions from raw material to production, processing and services to the transport of products, distribution and sale to the end-consumers – for activities allowed as per the Annex 2 of this decision.
- (b) The movement schedule for farmers and farm workers is from 06:00 until 20:00, for farmers, the following is required when moving outside: (i) Certificate of Farmer Registration, (ii) Annex 1 of the Certificate – Records of the registered farmer, and (iii) ID card.
- (c) Farm workers will be provided with a confirmation document from the MAFRD, only for the conduct of relevant farming activities.
- (d) With a special permit of movement and **only to conduct state institution needs**, movement of vehicles is allowed for essential staff of these institutions.
- (e) Vehicles are allowed to be used by people whose closest store/pharmacy/bank/point of payment is farther than 2 km. In these cases, the use of vehicles is not allowed to travel to another store/pharmacy/bank/point of payment except the closest one.
- (f) **Only to perform official duties**, movement of vehicles is allowed for institutions in the list attached as Annex 3 of this Decision.
- (g) Permits for movement in cases specified above, as per Annex 3, are issued by MIAPA.

- (h) Movement of vehicles is allowed for persons with disabilities the movement of whom requires vehicles.
- (i) Use of vehicles is allowed to travel to a health institution and seek treatment.
- (j) In cases of death, the use of vehicles is allowed to participate in the burial ceremony, **but only for the close members of the deceased person.**
- (k) **Except for the reason under item 1, more than two persons are not allowed per one vehicle.**
- (l) Exceptionally, media teams working in the field are allowed to have up to 3 persons in the vehicle provided that all 3 passengers are wearing special FFP2 masks and gloves.

III. During the allowed movement, with the exceptions under items I and II as above, natural persons are obliged as follows:

- (a) To cover the mouth and nose, with the use of a mask, scarf or other cover.
- (b) To keep a distance of two meters with other people, at all times.

IV. This decision shall enter into force the day it is signed and shall be valid until **May 18, 2020. The entry into force of this Decision shall repeal all previous provisions that contradict the provisions of this Decision.**

V. This Decision shall be reviewed no later than **May 16, 2020**, in consultation with the National Institute of Public Health, experts and other line ministries, to assess the efficiency and necessity of the determined measures, and to decide on the (non)continuation of the relevant measures.

VI. With exception of items IV and V, the Ministry of Health shall reanalyze the epidemiological situation on daily basis pertinent to any item outlined above, and may, after prior consultations, amend, complement or abolish the relevant measures.


R e a s o n i n g

In order to prevent and combat COVID-19 pandemics in the Republic of Kosovo, as well as in full compliance with Constitutional Court Judgments No. KO54/20 and KO61/20, based on its competencies defined under the Law No. 02 / L-109 on Prevention and Fighting of Contagious Diseases, Ministry of Health decided as outlined in the enacting clause of the present Decision.

Arben Vitia
Acting Minister of Health

Send Decision to:

- *Prime Minister of the Republic of Kosovo;*
- *Ministry of Internal Affairs and Public Administration;*
- *General Secretary of MoH;*
- *Legal Department of MoH;*
- *NIPHK;*
- *Mayor of Municipality of Obiliq;*
- *Kosovo Police;*
- *Sanitary Inspectorate;*
- *Emergency Operational Center of MoH;*
- *MoH Archives.*



Faza I

fillon me 04 maj 2020



3 orë në ditë

(sipas shifrës së parafundit të nr. personal – e ndarë në dy pjesë 90 min paradite 90 min pasdite)



Ndërtimtaria dhe patundshmëria^{2, 3}



Tregtia e Automjeteve (pjesërisht)^{1, 2, 3}



Tregtia me pakicë (pjesërisht)^{1, 2, 3}



Riparimi i artikujve personal dhe i orendive^{2, 3}




Zyrat e konsulencës
(me lista të stafit esencial)^{2, 3}

1 Shih listën e bizneseve të lejuara

2 Shih udhëzuesin për operimin e bizneseve

3 Konform rregullave të vendosura me protokollin epidemiologjik



Talas I

počinje od 04 maja 2020



3 sata dnevno

(Prema prethodnom broju ličnog broja – podeljeno u dva dela: 90 minuta pre podne, 90 minuta posle podne).



Gradnja i nekretnine^{2, 3}



Prodaja motornih vozila (delimično)^{1, 2, 3}



Maloprodaja (delimično)^{1, 2, 3}



Popravka ostalih ličnih i predmeta za domaćinstvo^{2, 3}



Kancelarije za konsultacije (samo neophodno osoblje)^{2, 3}

1 Videti spisak dozvoljenih delatnosti

2 Videti vodič za rad delatnosti

3 U skladu sa propisima utvrđenim u epidemiološkom protokolu



Wave I

starts on 04 may 2020



3 hours a day
(According to the the second to
last digit of the Personal Number)



Construction and real estate^{2, 3}



Sale of motor vehicles (partially)^{1, 2, 3}



Retail (partially)^{1, 2, 3}



Repair of other personal
and household items^{2, 3}



Consultancy offices
(essential staff only)^{2, 3}

1 See list of allowed businesses

2 See Business Operation Guide

3 In accordance with the rules established with the epidemiological protocol



Kufizime të veçanta për lokalet që shërbejnë klientë

1

Numri maksimal i lejuar i klientëve është një (1) person në 8m²

2

Pronarët e lokaleve janë të obliguar të publikojnë numrin maksimal të lejuar të personave para hyrjes së lokaleve.



Special restrictions for premises that serve clients

- 1** Within a given venue, the maximum number of allowed customers is (1) customer per 8m²
- 2** The owners of the premises are obligated to publish the maximum allowed number of individuals at the entrance of the respective venue.




Posebna ograničenja za prostorije koje opslužuju klijente

1

Unutar određenog mesta,
maksimalni broj dozvoljenih
kupaca je jedan (1) kupac za 8m²

2

Vlasnici prostorija dužni su da
na ulazu u određeno mesto,
objave maksimalno dozvoljeni
broj pojedinaca.



**Qarkullimi i qytetarëve
sipas shifrës së parafundit të
nr. personal – i ndarë në dy pjesë
90 min paradite, 90 min pasdite**

04-18 maj 2020 - Pa rotacion


07:00 - 08:30	0, 1, 2
09:00 - 10:30	3, 4, 5
11:00 - 12:30	6 & 7
13:00 - 14:30	8 & 9
15:00 - 16:30	0, 1, 2
17:00 - 18:30	3, 4, 5
19:00 - 20:30	6 & 7
21:00 - 22:30	8 & 9



**Kretanje građana prema
pretposlednjem broju ličnog broja
– podeljeno u dva dela: 90 minuta
pre podne, 90 minuta posle podne**

04-18 maja 2020 - Bez rotacije

07:00 - 08:30	0, 1, 2
09:00 - 10:30	3, 4, 5
11:00 - 12:30	6 & 7
13:00 - 14:30	8 & 9
15:00 - 16:30	0, 1, 2
17:00 - 18:30	3, 4, 5
19:00 - 20:30	6 & 7
21:00 - 22:30	8 & 9



Movement of citizens based on the second-to-last digit of personal number – divided into two segments (90 minutes AM, 90 minutes PM)

04-18 may 2020 - Without rotation

07:00 - 08:30	0, 1, 2
09:00 - 10:30	3, 4, 5
11:00 - 12:30	6 & 7
13:00 - 14:30	8 & 9
15:00 - 16:30	0, 1, 2
17:00 - 18:30	3, 4, 5
19:00 - 20:30	6 & 7
21:00 - 22:30	8 & 9

KODI	Veprimtaria	P/J	P/J
0111	Kultivimi i drithërave (përveç orizit), i bimëve bishtajore dhe i farërave vajore	PO	PO
0112	Kultivimi i orizit	PO	PO
0113	Kultivimi i perimeve, pjepërave dhe shalqirit, bimëve rrënjore dhe tuberoze	PO	PO
0114	Kultivimi i kallamsheqerit	PO	PO
0115	Kultivimi i duhanit	PO	PO
0116	Kultivimi i bimëve fibroze	PO	PO
0119	Kultivimi i bimëve të tjera njëvjeçare	PO	PO
0121	Kultivimi i hardhive	PO	PO
0124	Kultivimi i frutave me bërthamë dhe frutave me farë	PO	PO
0125	Kultivimi i frutave të tjera pemore, shkurreve dhe arrave	PO	PO
0126	Kultivimi i frutave vajore	PO	PO
0127	Kultivimi i kulturave për prodhimin e pijeve	PO	PO
0128	Kultivimi i erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore	PO	PO
0129	Kultivimi i bimëve të tjera shumëvjeçare	PO	PO
0130	Shumimi i bimëve	PO	PO
0141	Rritja e gjedheve për qumësht	PO	PO
0142	Rritja e gjedheve të tjera dhe buallicave	PO	PO
0143	Rritja e kuajve dhe njëthundrakëve	PO	PO
0145	Rritja e deleve dhe dhive	PO	PO
0146	Rritja e derrave	PO	PO
0147	Rritja e shpezëve	PO	PO
0149	Rritja e kafshëve të tjera	PO	PO
0150	Fermat e përziera	PO	PO
0161	Veprimtaritë ndihmëse për prodhimet bimore	PO	PO
0162	Veprimtaritë ndihmëse për prodhimet blegtorale	PO	PO
0163	Veprimtaritë e paskorrjes së bimëve	PO	PO
0164	Përpunimi i farërave për shumim	PO	PO
0170	Gjuetia, vënia e pusive dhe veprimtaritë e tjera shërbyese	PO	PO
0210	Kulturat pyjore dhe veprimtaritë e tjera të pylltarisë	PO	PO
0220	Prerja e drunjve	PO	PO
0230	Mbledhja e produkteve pyjore të egra, jo drusore, rritur në natyrë	PO	PO
0240	Shërbime mbështetëse ndaj pyjeve	PO	PO
0311	Peshkimi detar	JO	JO
0312	Peshkimi në ujra të ëmbla	PO	PO
0321	Akuakultura detare	JO	JO
0322	Akuakultura në ujra të ëmbla	PO	PO
0510	Nxjerrja e qymyrit të fortë	PO	PO
0520	Nxjerrja e linjiteve	PO	PO
0610	Nxjerrja e naftës së papërpunuar	JO	JO
0620	Nxjerrja e gazit natyror	JO	JO
0710	Nxjerrja e xehes së hekurit	PO	PO
0721	Nxjerrja e xeheve të uraniumit dhe toriumit	PO	PO
0729	Nxjerrja e xeheve të tjera jo-metallore	PO	PO
0811	Nxjerrja e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gelqeror, gjipsit, shkumësit dhe rrasave	PO	PO

0812	Nxjerrja e zhavorrit dhe rërës, nxjerrja e argjillës dhe kaolinit	PO	PO
0891	Nxjerrja e mineraleve kimike dhe plehërave kimikë	PO	PO
0892	Nxjerrja e torfës	PO	PO
0893	Nxjerrja e kripës	PO	PO
0899	Veprimtaritë e tjera nxjerrëse dhe gurore p.k.t.	PO	PO
0910	Veprimtaritë mbështetëse për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror	JO	JO
0990	Veprimtaritë mbështetëse për nxjerrjen e produkteve të tjera nga nëntoka	JO	JO
1011	Përpunimi dhe konservimi i mishit	PO	PO
1012	Përpunimi dhe konservimi i mishit të shpezëve	PO	PO
1013	Prodhimi i produkteve të mishit dhe i mishit të shpezëve	PO	PO
1020	Përpunimi dhe konservimi i peshkut, krustaceve dhe molusqeve	PO	PO
1031	Përpunimi dhe konservimi i patates	PO	PO
1032	Përpunimi i lëngut të frutave dhe perimeve	PO	PO
1039	Përpunimi dhe konservimi tjetër i frutave dhe perimeve	PO	PO
1041	Përpunimi i vajrave dhe yndyrnave	PO	PO
1042	Prodhimi i margarinës dhe yndyrnave të tjera të ngjashme	PO	PO
1051	Prodhimi i produkteve të qumështit	PO	PO
1052	Prodhimi i akullores	PO	PO
1061	Përpunimi i produkteve të drithërave	PO	PO
1062	Përpunimi i niseshtës dhe i produkteve të niseshtes	PO	PO
1071	Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta	PO	PO
1072	Prodhimi i biskotave dhe galetave; prodhimi i pastave dhe kekëve të konservuar	PO	PO
1073	Prodhimi i makaronave, shpagetave dhe produkteve të ngjashme nga mielli	PO	PO
1081	Prodhimi i sheqerit	PO	PO
1082	Prodhimi i kakaos, çokolatës dhe ëmbëlsirave	PO	PO
1083	Përpunimi i çajit dhe kafes	PO	PO
1084	Përpunimi i erëzave dhe salcave	PO	PO
1085	Përpunimi i ushqimeve dhe gjellëve të gatshme	PO	PO
1086	Përpunimi i ushqimeve të homogjenizuara dhe ushqimeve dietike	PO	PO
1089	Përpunimi i produkteve të tjera ushqimore p.k.t	PO	PO
1091	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës	PO	PO
1092	Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët shtëpiake	PO	PO
1101	Destilimi, rafinimi dhe kombinimi i pijeve	PO	PO
1102	Prodhimi i verës nga rrushi	PO	PO
1103	Prodhimi i mushtit dhe verërave të tjera me bazë frutash	PO	PO
1104	Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të padestiluara	PO	PO
1105	Prodhimi i birrës	PO	PO
1106	Prodhimi i majës së birrës	PO	PO
1107	Prodhim i pijeve freskuese; prodhimi i ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe	PO	PO
1200	Prodhimi i produkteve të duhanit	PO	PO
1310	Përgatitja dhe thurja e fijeve të tekstilit	PO	PO
1320	Endja e tekstilit	PO	PO
1330	Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit	PO	PO
1391	Prodhimi i pëlthurave të thurura dhe të endura	PO	PO

1392	Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve	PO	PO
1393	Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve	PO	PO
